

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI:
REALIZIM PARKIM PER BIÇKLETA



TABELA E PERMBAJTJES

- I. TE PERGJITHSHME
- II. PRERJA E SIPERFAQES EKZISTUESE
- III. GERMIMI I MATERIALEVE PER KRIJIMIN E BAZAMENTIT
- IV. BETONI
- V. PRODHIMI I ELEMENTEVE PREJ INOKSI A.I.S.I. 316
- VI. INSATLIMI I ELEMENTEVE PER VENDPARKIMIN

I. TE PERGJITHSHME

Për pozicionimin e vëndparkimeve të bicikletave janë zgjedhur vende kyce si institucione dhe zona me frekuentim të lartë. Për pozicionimin e vëndparkimeve subjekti ndertues do ti referohet projektit, por do të konsultohet dhe me projektuesin për çdo vend parkim rast pas rasti, sepse mund të kemi levizje të pozicioneve të tyre gjatë zbatimit.

II. PRERJA E SIPERFAQES EKZISTUESE

Për realizimin e bazamentëve të betonit në vendin ku do të pozicionohet vëndparkimi i bicikletave në fillim duhet prer me gur smeril dore dhe me disk prerës (për prerje të sipërfaqeve të forta si gure, asfalt beton etj) në mënyrë të rregullt formati i bazamentit që është 20cm x 20cm, në mënyrë që mos të demtohet cilësia estetike e sipërfaqes ekzistuese.

III. GERMIMI I MATERIALEVE PER KRIJIMIN E BAZAMENTIT

Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve sic tregohet në Vizatime. Çdo thellësi më e madhe e gërmuar nën nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të behët mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.

Kujdes i vecantë duhet të ushtrohet kur gërmohen prerje për të mos hequr material përtej vijes së specifikuar të prerjes dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmëri strukturore të pjerrësise ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimit të pjerrësive të ngjeshura.

Përmasat e prerjeve duhet të jenë në përputhje me detajet sic tregohen në Vizatime.

IV. BETONI

Betonimi i bazamentëve do të behët me beton C20/25, para se të betonohet duhet të vendosen të paktën 2 shufra hekuri $\varnothing 6$ mm me gjatësi 35cm të cilat do të inkastrohen në nënshtresat e sipërfaqes ekzistuese. Gjatë betonimit duhet të meren masa për të lënë hapësirën për inkastrimin e tubit të inoksit me minimumi 5cm në aksin e bazamentit. Pas betonimit duhet që cilësia estetike e sipërfaqes ekzistuese të kthehet në gjendjen e mëparshme duke e shtruar me materialin e mëparshëm qofte gure, mermer travertin, pllaka vetstinguese etj).

V. PRODHIMI I ELEMENTEVE TE INOKSIT A.I.S.I. 316

Elementët prej inoksi A.I.S.I. 316 përbëhen prej dy tuba me diametër Ø33.7 dhe me spesor 1.65mm duhet të jenë me gjatësi 6 metra të ciët duhet të kalojnë në proces kalandrimi me jashtëqendërsi si në vizatimet përkatëse për të marrë formën e sustes dhe gjatë kalandrimit duhet të tregohet kujdes i vecantë që kollona e fillimit dhe e mbarimit (që janë pikat e inkastrimit në bazament të jenë të drejta dhe paralele me njeri-tjetrin (në perputhje me detajet sic tregohen në vizatime). Pas kalandrimit duhet që rifinitura finale të jetë pa shkelqim por të jete uniforme dhe mos të ketë shenja gervishje (shenja të cilat janë pjesë e procesit të kalandrimit), të meren të gjitha masat për heqjen e shenjave të kalandrimit dhe punimit. Në dy kolonat e inkastrimit të elementit do të saldohen me elektroda për saldimitin e inoksit, anti-oksiduese, profile L 70x45x5mm në dy krahe perpendikular me drejtimin e elementit për parkimin e bicikletave, në këtë mënyrë sigurohet një qendrueshmeri më e madhe përgjat akseve të mundshme të sforcimeve. Saldimet duhet të kenë një tegel konsistent dhe estetik preferohet saldimit TIG. TIG qëndron për Tungsten Inert Gas dhe quhet teknikisht saldimit me hark në gaz dhe Tungsten ose GTAË. Procesi përdor një elektrodë të tungstenit që nuk konsumohet, e cila sjell rrjedhën elektrike në harkun e saldimit. Elektroda e Tungstenit dhe zona e saldimit janë të mbrojtura dhe të ftohura me një gaz inert, zakonisht argon. Të sigurohet që tegeli i saldimit të ketë një penetrimit të mirë dhe që saldimiti i dy elementeve të inoksit të jete efikas dhe i qendrueshëm.

VI. INSTALIMI I ELEMENTEVE PER VENDPARKIMIN

Pas betonimit të bazamentit dhe marrjes të të gjitha masave të përkujtuara më sipër, minimumi i kohës së fillimit për montimin e elementit për vendparkimin duhet të jetë 7 ditë pas betonimit të bazamentit. Instalimi i elementeve të inoksit do të inkastrohet 5cm në bazament në hapsirën e lënë gjatë betonimit të bazamentit. Në profilet e salduar në elementët e inoksit janë parashikuar vrima për bulonimin e elementit me bazamentin, duke saktësuar pozicionin e vrimave do të behen shpime me trapan elektrik për vendosjen e upave të inoksit. thellesia e shpimeve do të jetë 15cm dhe gjatësia e bulonave prej inoksi të klases specifike sipas tubit, duhet të jete minimumi 18cm. Pas bulonimit të elementit datot shtrënguese do të saldohen me elektroda inoksi saldimit me metoden TIG, për sigurimin permanent të vendparkimit

Ark. Adnand Tocila

Ing. Eni Turkeshi

